

Data 21.08.2024

## **PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Licensash Microsoft si dhe instalime dhe konfigurime të zgjidhjes Microsoft, për administrimin e aktiviteteve operacionale të institucionit”**

---

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): - pakete software menaxhimi licensash.**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 299,641,982 (dyqind e nëntëdhjetë e nëntë milion e gjashtëqind e dyzet e një mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, ose 2,997,918.78 (dy million e nentëqind nentëdhjetë e shtate mije e nentëqind e tetëmbëdhjetë pike shtatëdhjetë e tete) Euro pa tvsh, shenim: referuar kursit të B.SH date 21.08.2024, 1 euro =99,95 ALL.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor OSHEE Group Sh.A ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “OSHEE GROUP” sh.a. ka vendosur që kjo procedure të mos jete ne lote sipas arsyetimit të meposhtem:**

Kjo kontrate nuk është ndare në lote pasi administrimi i saj do të bëhet nga OSHEE Group sh.a,DTI si dhe ndjekja dhe zbatimi i kontratës do të bëhet nga Departamenti i Teknologjise dhe Informacionit, ndarja dhe frangmentimi i saj do të krijonte kompleksitet dhe vështiresi në zbatim.

Gjithashtu objekti i kontratës lidhet me furnizim me mallra licensa dhe shërbime të lidhura me to, që tregohen nga operator ekonomik të cilët ofrojnë të dyja kategoritë mallrave të kërkuara. Përsa me lart ndarja në lote do ta nderlikonte dhe vështiresonte furnizimin dhe procesin e zbatimit të kontratës duke krijuar vonesa dhe shpenzime operative shtese dhe rrjedhimisht do sillte vështiresi dhe vonesa për menaxhimin e kontratës duke dubluar një sere procesesh zinxhir. OSHEE Group sh.a në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara me kompanitë bija në varesi ka marrë për siper të ofroje të gjitha shërbimet lidhur me proceset e prokurimit dhe menaxhimit të kontratave, ndaj në këto kuader ka krijuar struktura dhe trajnuar personel për mbulimin e këtyre shërbimeve.

#### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës...

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

---

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit .....

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2. 1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare, 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **100%** e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43/2/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Duke marrë në konsideratë llojin e mallrave dhe koheshtrirjen e kontratës për këtë objekt procedure prokurimi, kerkohet që OE ofertues të deshmojë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar ato në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kerkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim është kërkuar vërtetim i xhiros për tre vitet e fundit në një vlerë jo më e vogël se **100%** e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet .

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar neni 13 pika 2: “*Tatimpaguesit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore, jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi*”.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. ***Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.***

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligji nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe në zbatim të Nenit 41, pika c, të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 35 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 35 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

---

Duke marrë në konsideratë sasine dhe cilësinë e mallrave të kërkuar në këtë objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë realizuar me kontrata të ngjashme, të jetë afër limitit maksimal dhe në këtë mënyrë, AK krijon sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi me sukses dhe pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikojnë në ecurinë e punës së AK.

---

## **2.4.Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

### **2.4.1 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar si kompani sipas standardeve ndërkombëtare me:**

- a) **ISO 9001:2015** ose ekuivalente, të sistemit të menaxhimit të cilësisë (e vlefshme);
- b) **ISO 27001:2013** ose ekuivalente, për Sigurinë e Informacionit (e vlefshme);
- c) **ISO/IEC 20000-1:2018** ose ekuivalente, për menaxhimin e shërbimeve të teknologjise së informacionit (e vlefshme);

*Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet. Certifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

*Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 dhe 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) dhe nenit 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

**Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.**

Çertifikimi **ISO 9001:2015** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë implementuese. Ky certifikim kërkohet në përputhje me proporcionalitetin e vlerës së fondit limit të vënë në dispozicion dhe bazuar në kompleksitetin dhe rëndësinë e funksionalitetit online të sistemeve aktuale që OSHEE Group sh.a. ka në përdorim;

Çertifikimi **ISO 27001:2013** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke siguruar që informacionet (siç janë ato që përmbajnë sistemet ekzistuese të AK dhe e kanë një rëndësi dhe konfidencialitet

të lartë) të menaxhohen në menyrë të sigurtë nga pikëpamja informatike dhe të jenë të kontrolluara dhe si dhe aksesimi mbi to të jetë i verifikueshëm e i kodifikuar). Kjo vjen pasi në këtë kontratë do ketë edhe përdorim të aplikacioneve të reja për diagnostikimin e elementëve të sigurisë së sistemeve ekzistuese që kërkojnë kompetencë të shtuar profesionale në këtë drejtim. Ky çertifikim kërkohet në përputhje me proporcionalitetin e vlerës së fondit limit të vënë në dispozicion dhe bazuar në kompleksitetin dhe rëndësinë e funksionalitetit online të sistemeve aktuale që OSHEE Group sh.a. ka në përdorim;

Çertifikimi **ISO 20001-1:2018** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke qënë se zotëron një sistem menaxhimi për shërbimet e teknologjisë së informacionit, duke pasur më shumë garanci që ky i fundit të planifikojë, krijojë, zbatojë, monitorojë, rishikojë, mirëmbajë dhe përmirësojë të gjithë sistemin në tërësi i cili është tërësisht i bazuar në produkte TIK (software dhe hardware). Ky çertifikim kërkohet në përputhje me proporcionalitetin e vlerës së fondit limit të vënë në dispozicion dhe bazuar në kompleksitetin dhe rëndësinë e funksionalitetit online të sistemeve aktuale që OSHEE Group sh.a. ka në përdorim;

**2.4.2** Operatori ekonomik duhet të vërtetojë që ka të paktën 10 (**dhjetë**) **Inxhinierë/Specialistë** të diplomuar në degët e Inxhinierisë Elektronike/Inxhinieri Informatike/Teknologji Informacioni/Informatikë/Informatikë Matematikë/Inxhinieri Matematike dhe Informatikë/Informatikë Ekonomike/Telekomunikacion/Inxhinieri Telekomunikacion/Inxhinieri Gjeoinformatike, që do të angazhohen në implementimin e projektit, kriter që duhet të vërtetohet nëpërmjet:

- *Listepagesat e punonjesve dorezuara nepermjet formes elektronike ne organet kompetente;*
- *Diplomat e inxhinierëve.*

**Sqarim :** përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të **formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST**, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).*

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 pika (4) të LPP, ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

**2.4.3** Operatori ekonomik duhet të gëzojë statusin e nevojshëm të partneritetit për licensim me Microsoft për shitjen e produkteve në objekt të kësaj kontrate.

**2.4.4** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin me sukses të kontratës, duhet të ketë të punësuar dhe të disponojë si staf të tij personelin kryesor teknik, si më poshtë:

a. *Të paktën 1(nje) punonjës të certifikuar si ekspert për administrimin e produkteve M365 nga Microsoft, ose ekuivalent.*

**Argumentimi:** Përfshirja e punonjësve të certifikuar në administrimin e platformave M365 në nivelin Ekspert në zhvillimin e këtij projekti është shumë e rëndësishme për të siguruar që shërbimet teknike të nevojshme gjatë zhvillimit të projektit të jetë cilësore dhe efektive. Duke menaxhuar rreziqet potenciale dhe duke përdorur teknologjitë më bashkëkohore, eksperti i zgjidhjeve optimizon performancën dhe garanton efektivitetin e ekipit në kryerjen e detyrave të kësaj kontrate.

b. *Të paktën 2(dy) punonjës të certifikuar si ekspert për produktet Microsoft, paketeta productivity të Microsoft, ose ekuivalente*

**Argumentimi:** Përfshirja e punonjësve të certifikuar me Microsoft productivity siguron cilësi të lartë në shërbime gjatë ekzekutimit të kontratës. Microsoft Productivity është një grup produktesh që përfshin Cloud Computer Systems Administration, Data Loss Prevention, Data Security, Exchange Server, Microsoft 365, Office 365, SharePoint Server etj. komponente të cilat janë në objekt të blerjes dhe shërbimeve të kësaj kontrate

c. *Të paktën 1(një) punonjës të certifikuar si ekspert i zgjidhjeve Microsoft, në fushën e infrastruktures baze, ose ekuivalente*

**Argumentimi:** Përfshirja e punonjësve të certifikuar me Microsoft Infrastruktura baze, siguron cilësi të lartë në shërbime gjatë ekzekutimit të kontratës. Microsoft Infrastruktura baze (Core infrastructure) është e fokusuar në implementimin, administrimin, mirëmbajtjen dhe garantimin e sigurisë së serverave Windows, në çfarë do roli qofshin ato, si psh Domain Controllers dhe AD servers, DNS, DHCP etj. Këto shërbime janë aktualisht të implementuara në infrastrukturen e OSHEE, por duhet të bëhet upgrade në versionin e fundit të tyre, si dhe është kërkuar të kryhen shërbime optimizimi në konfigurimin e Active Directory dhe windows server. Komponente të cilat janë në objekt të blerjes dhe shërbimeve të kësaj kontrate

d. *Të paktën 1(nje) punonjës të certifikuar në Office 365 nga Microsoft ose ekuivalente.*

**Argumentimi:** Përfshirja e të paktën 1 punonjësi të certifikuar në Office 365 gjatë këtij projekti është e rëndësishme për të siguruar që të konfigurimet e nevojshme të tenantit përkatës që do të vihet në përdorim me blerjen e produkteve Microsoft.

e. *Të paktën 1(një) punonjës të certifikuar si Menaxher Projekti.*

**Argumentimi:** Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën një punonjës të certifikuar si menaxher projekti, për të siguruar zhvillimin e suksesshëm të projektit sipas standarteve dhe praktikave më të mira botërore duke marrë në konsideratë rëndësinë dhe kompleksitetin e projektit. Një menaxher projekti është përgjegjës për ndjekjen e të gjithë ciklit të një projekti implementimi, që prej analizës dhe dizenjimit të kërkesave, parametrizimeve dhe konfigurimeve të sistemit, testimit, trajnimit dhe dokumentimit të projektit..

*f. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për Testime Aplikacionesh.*

**Argumentimi:** Përfshirja e një punonjësi të certifikuar për Menaxher Testimesh aplikacionesh, do të garantojë një përfaqje profesionale dhe të specializuar në testimin e zgjidhjes së Platformes Analitike që do të kërkohej të implementohej. Ky punonjës duhet të ketë njohuri të thella në strategjitë dhe metodologjitë e testimit, duke siguruar cilësi të lartë dhe performancë të përmirësuar për zgjidhjen.

*g. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalente).*

**Argumentimi:** Kërkesa për një punonjës të certifikuar për "ITIL" ose ekuivalente lidhet me rezultatet që duhet të përmbushen nga Operatori Ekonomik, sipas kërkesave të shprehura në DST ku përcaktohen kohët e ndërhyrjeve dhe termat e tjera të nivelit të shërbimit SLA (shërbimet e mirëmbajtjes). Një certifikim ITIL është një set praktikash dhe kuadri rregullash dhe idesh për realizimin e shërbimit në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, që është pjesë e qëllimit të projektit të autoritetit kontraktor.

*h. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si data analist nga Microsoft ose ekuivalente.*

**Argumentimi:** Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si data analist për implementimin dhe mirëmbajtjen e zgjidhjeve BI Platform e cila është objekt i shërbimeve të kësaj kontrate.

*i. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si Inxhinier të Dhënash nga Microsoft ose ekuivalente.*

**Argumentimi:** Përfshirja e të paktën 1 punonjësi të certifikuar si inxhinier të dhënash është e domosdoshme për të siguruar një qasje efektive ndaj zhvillimit të platformës analitike BI.

**Shënim:** Një punonjës mund të ketë më shumë se një certifikim.

**Shënim:** Kërkesat për certifikimet e mësipërme duhet të vërtëtohen me Certifikatat ose Transkriptet përkatëse (të përkthyer në shqip dhe të noterizuar).

**Shënim:** Personeli i mësipërm duhet të ketë marrëdhënie pune me operatorin ekonomik për periudhën e 3 mujorit të fundit (qershor-gusht 2024), e vërtetuar kjo me formularin e E-sig të listëpagesave të dorëzuara nepermjet formes elektronike ne organet kompetente.

**Sqarim :** përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet

edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).*

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

***Specifikimet teknike fondi limit dhe kriteret e vecanta per kualifikim jane hartuar nga strukture e posacme e ngritur me urdher te titullarit te autoritetit kontraktor.***

**Njësia e Prokurimit:**